



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljehen/Prodato Received/Delivery	09.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/STICK	7864/2022		116



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.908/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.908/2022 të datës 14.10.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi kundër organit të punësimit/Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 09.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.908/2022 e datës 14.10.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Njoftimi me numër 01-138/22 i datës 27.09.2022 i Zyrës së Personelit, si dhe Lista mbi renditjen përfundimtare të kandidatëve e datës 03.10.2022 tek SIMBNJ, faza e vlerësimit përfshirë testimin me shkrim, jetëshkrimin dhe intervistën me gojë lidhur me konkursin për pranim me numër reference RN00009496 të shpallur me datë 18.07.2022 nga Komuna e Ferizajit, për grupin "Specialist të Administrimit të Përgjithshëm" lidhur me pozitat "Asistent administrativ 4" në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit", "Zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme" në Drejtorinë e financave si dhe "Zyrtar për gjendje civile 4" në Drejtorinë e administratës së përgjithshme.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Ferizajt, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të vendimit të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, ashtu që procedura e rekrutimit sipas

konkursit me numër referencë RN00009496 të vazhdoj nga faza e verifikimit paraprak në pajtim me pikëpamjet juridike sipas këtij vendimi dhe dispozitat ligjore në fuqi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja me datën 14.10.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6173/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.908/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.01-144/22 të datës 03.10.2022 të Komisionit të Vlerësimit të Komunës së Ferizajt.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 17.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Ferizajt, ndërsa me datën 25.10.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Ferizajt së bashku me shkresat ndërlidhur me çështjen në procedurë.

Me datën 25.11.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.173/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6173/2022 të datës 14.10.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.01-144/22 të datës 03.10.2022 për refuzimin e ankesës së ankueses; Njoftimet e datës 13.10.2022 nga SIMBNJ për ankuesen; Shkresën zyrtare të datës 03.10.2022 mbi rezultatet përfundimtare pas afatit të ankesave; Kopjen e ID-së dhe letërnjoftimit të ankueses; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankues me numër 03-112/570 të datës 07.05.2012; Akt emërimit me numër 02-112/570 të datës 24.04.2014 të ankueses; Dokumentet relevante lidhur me dëshmitë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, trajnimet, trustin si dhe certifikatën e gjykatës së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 17.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 25.10.2022 nga Komuna e Ferizajt së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin me numër RN00009496 të datës 18.07.2022; Vendimin për themelimin e komisionit të vlerësimit me numër 01 Nr.01-75.22 të datës 19.08.2022; Ndryshim plotësimin e akt emërimit me numër 01Nr.16/18 të datës 11.01.2018 për Ndryshim plotësimin e akt emërimit me numër 01Nr.38/18 të datës 12.01.2018 për Ndryshim plotësimin e akt emërimit të datës 15.05.2014 për V.SH; Akt emërimit të datës 01.07.2011 për V.K; Ndryshim plotësimin e akt emërimit të datës 01.05.2020 për Kontratën me numër 01.Nr.01-45/2022 të datës 20.04.2022 për Listën e aplikantëve e gjeneruar tek sistemi SIMBNJ; Listën e ngushtë të kandidatëve me numër 01.Nr.01-103/2022 të datës 31.08.2022; Listën e ngushtë të kandidatëve pas afatit të ankesave me numër 01.Nr.01-108/2022 të datës 05.09.2022; Listën me rezultatet e vlerësimit të kandidatëve me numër 01-138/2022 të datës 27.09.2022; Renditjen përfundimtare të kandidatëve e gjeneruar tek SIMBNJ 03.10.2022; Ankesën e ankueses të datës 29.09.2022 e parashtruar tek komisioni i vlerësimit; vendimin me numër Nr.01-144/2022 të datës 03.10.2022 nga komisioni i vlerësimit; Formularët e

vlerësimit individual të kandidatëve të intervistës me gojë të datës 27.09.2022 nga komisioni i vlerësimit; Formularët e vlerësimeve individuale të kandidatëve për biografi të datës 19.09.2022 nga komisioni i vlerësimit; Aplikacionin me numër RN00009496 të datës 15.08.2022 për kandidaten së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit , certifikatat e trajnimeve dhe atë nga gjykata si dhe trustin; Aplikacionin me numër RN00009496 të datës 19.08.2022 për kandidaten së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit , certifikatat e trajnimeve dhe atë nga gjykata si dhe trustin; Shkresat zyrtare të datës 27.05.2014, 10.02.2017 si dhe 17.11.2017 nga Komuna e Ferizajt; Aplikacionin me numër RN00009496 të datës 23.08.2022 për kandidaten Sh.T së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, certifikatat e trajnimeve dhe atë nga gjykata; Aplikacionin me numër RN00009496 të datës 15.08.2022 për kandidatin E.O së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit si dhe certifikatat e trajnimeve; Aplikacionin me numër RN00009496 të datës 17.08.2022 për kandidaten A.J së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatat e trajnimeve dhe atë nga gjykata; Aplikacionin me numër RN00009496 të datës 23.08.2022 për kandidaten L.H së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit , certifikatat e trajnimeve dhe atë nga gjykata; Aplikacionin me numër RN00009496 të datës 09.08.2022 për kandidaten H.I së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, kopjen e letërnjoftimit , certifikatën nga gjykata si dhe trustin dhe Vendimin VK.nr.173/2022 të datës 25.11.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Komuna e Ferizajt fillimisht me datën 18.07.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 09.08.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë të Administrimit të Përgjithshëm me numër të referencës RN00009496 lidhur me pozitat "Asistent administrativ 4" në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit", "Zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme" në Drejtorinë e financave si dhe "Zyrtar për gjendje civile 4" në Drejtorinë e administratës së përgjithshme, në të cilin konkurs sipas ankesës në këshill ka aplikuar edhe ankuesja për pozitën "Zyrtar për gjendje civile 4" në Drejtorinë e administratës së përgjithshme duke u përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit.

Sipas shkresës së gjeneruar tek SIMBNJ të datës 03.10.2022 lidhur me renditjen përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm e hartuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit del se, kandidatët e përzgjedhur për pozitat e lartcekura janë: e vlerësuar me gjithsejtë 80.4 pikë, duke u renditur si kandidatja e parë në listë, e vlerësuar me gjithsejtë 77.8 pikë duke u renditur si kandidatja e dytë në listë, si dhe e vlerësuar me gjithsejtë 73.8 pikë duke u renditur e dhjeta me gjithsejtë 67 pikë.

Ankuesja e pakënaqur me renditjen përfundimtare, parashtron ankesë pranë Komisionit të Vlerësimit, i cili me Vendimin me numër Nr.01-144/22 të datës 03.10.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar. Kundër këtij vendimi ankuesja brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se e njëjta nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë nga komisioni i vlerësimit lidhur me vlerësimin e biografisë, përvojës dhe trajnimit, si dhe e njëjta pretendon se nuk i janë llogaritur në mënyrë të

drejtë pikët e testimit dhe me gojë, andaj kërkon që të bëhet rivlerësimi i dokumentacionit të saj ngase i është bërë e padrejtë në këtë drejtim.

Kolegji i Këshillit pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit „Specialist i Administrimit të Përgjithshëm”, në Komunën e Ferizajt, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00009496 lidhur me pozitat “Asistent administrativ 4” në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, “Zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme” në Drejtorinë e financave si dhe “Zyrtar për gjendje civile 4” në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja për pozitën “Zyrtar për Gjendje Civile 4” në Drejtorinë e administratës së përgjithshme, kanë qenë si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare në Juridik ose Administratë Publike me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune.*

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me vlerësimin e biografisë, përvojës së punës dhe trajnimeve nga ana e Komisionit të pranimit, ka konstatuar se ankuesja në bazë të renditjes përfundimtare të kandidatëve sipas listës së gjeneruar tek Simbnj e datës 03.10.2022, del se nga testimi me shkrim ka marrë 50 pikë, nga jetëshkrimi 10.04. pikë, nga intervista me gojë 6.6 pikë me gjithsejtë pike te grumbulluara prej 67 pikë. Bazuar në këtë fakt Kolegji i Këshillit konstaton, se sipas dëshmimeve të dërguara nga ana e ankueses si dhe të komunës së Ferizajt për dosjen e ankueses, rezulton se e njëjta ndërlidhur me përvojën profesionale ka prezantuar Diplomën me numër NR.971 të datës 21.09.2010, me të cilën dëshmohet se me datën 14.07.2008 ka përfunduar studimet në Universitetin e Prishtinës-Fakulteti Juridik dhe ka marrë titullin “Bachelor i drejtësisë”, si përvojë të punës ka prezantuar: Kontratën e marrëdhënies së punës me numër 03-112/570 të datës 07.05.2012 e lidhur ndërmjet saj dhe Komunës së Vitisë me datën 01.05.2012 deri 31.07.2012 në pozitën “Regjistruese civile” në kuadër të Departamentit të Administratës së përgjithshme, Akt emërimit me numër 02-112/570 të datës 24.04.2014 të lëshuar nga Komuna e Vitisë, sipas së cilës dëshmohet se nga data 01.05.2014 e njëjta ka punuar në pozitën “Regjistruese civile” në kuadër të Departamentit të Ofiqarisë, ndërsa lidhur me fushën e trajnimeve e njëjta ka prezantuar: Certifikatën të lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin për zyrtarët e gjendjes civile të datës 06.11.2015, Certifikatën me numër Nr.02/26 të datës 11.02.2016 të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme-Agjencia e Regjistrimit Civil sipas së cilës e njëjta është certifikuar zyrtare profesionale për gjendjen civile, Certifikatën e datës 20.12.2012 të lëshuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil sipas se cilës me datën 12.12.2012 ka kryer trajnimin për kodin e etikës, anti korrupsion dhe mbrojtjen e të dhënave personale si dhe Certifikatën e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike sipas se cilës për periudhën nga datat 19-20 nëntor të vitit 2015 ka marre pjese ne trajnimin Korniza e përbashkët vetë-vlerësimit (KPV), e që me këtë rast Komisioni i Pranimit ndërlidhur me vlerësimin e biografisë, përvojës së punës dhe trajnimeve ka vepruar ne kundërshtim me nenin 22 paragrafin 4 nën paragrafin 4.1, 4.2, dhe 4.3 të Rregullores (QRK) Nr 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin është përcaktuar se: “1.Pas testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me vlerësimin e jetëshkrimit. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri ne njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri ne tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin

të arsimimit; 4.2. deri ne shtate (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri ne pesë (5) pikë për trajnimet”, ngase e njëjta sipas fakteve të konstatuara si me lartë nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë nga ana e komisionit lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit, sepse në këtë fazë ka marrë vetëm 10.4 pikë, ndërsa sipas dëshmimeve të administruara nga kolegji del se ankuesja ndërlidhur me dëshminë mbi përvojën profesionale ka dëshmuar se e plotëson kriterin e përvojës së punës sipas konkursit për arsimimin e kërkuar ngase ka paraqitur diplomën përkatëse për këtë fushë të kërkuar, po ashtu tek pjesa e përvojës së punës e njëjta ka dëshmuar se ka plotësuar kushtin mbi përvojën e punës lidhur me pozitën për të cilën ka aplikuar, si dhe tek fusha e trajnimit po ashtu ka paraqitur certifikatat me të cilat ka dëshmuar se ka përfunduar trajnimet lidhur me fushën përkatëse për pozitën e kërkuar të punës si “Zyrtar i gjendjes civile 4” pranë Drejtorisë së administratës së përgjithshme, andaj Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankueses se e njëjta nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë nga ana e Komisionit të Vlerësimit janë të bazuara dhe ligjore, sepse në këtë fazë të vlerësimit e njëjta në bazë të dokumentacionit të cilin e ka paraqitur sipas dosjes së aplikimit, ka arritur të dëshmojë se i ka plotësuar kushtet për vlerësim maksimal të pikëve në këtë fazë të vlerësimit dhe rrjedhimisht për rastin konkret të ankueses, Komisioni i Pranimit dhe Vlerësimit të Komunës së Ferizajt ndërlidhur me vlerësimin e ankueses për këtë fazë, ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 16 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sipas se cilës është përcaktuar se: “1. Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Pranimit i themeluar në pajtim me nenin 17 dhe/ose përkatësisht nenin 18 të kësaj Rregulloreje. 2. Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë”.

Bazuar në rrethanat si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se nuk mund të vazhdohet një procedurë pranimit përderisa komisioni i pranimit, ndërlidhur me rastin e ankueses nuk ka bërë vlerësim të drejtë dhe ligjor sipas fakteve dhe dëshmimeve të cilat i ka paraqitur ankuesja me rastin e aplikimit dhe se ky veprim është në kundërshtim me frymën e normës juridike, andaj në pajtim me këtë vendim është i obliguar që sipas udhëzimeve të dhëna në këtë vendim, të bëjë vlerësim të drejtë dhe ligjor bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit, vlerëson se çdo veprim i ndërmarrë nga Komisioni i Pranimit, pas fazës së verifikimit paraprak është i kundërligjshëm, kështu që për arsyet që të mos vie deri tek anulimi i procedurës në tërësi, pas veprimeve të ndërmarra nga Komisioni i pranimit ndërlidhur me vlerësimin e aplikacionit të ankueses, atëherë të vazhdohet me procedurën e pranimit për grupin „Specialist i Administrimit të Përgjithshëm”, në Komunën e Ferizajt, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00009496 lidhur me pozitën “Asistent administrativ 4” në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, “Zyrtar për evidentimin e pronës së paluajtshme” në Drejtorinë e Financave si dhe “Zyrtar për gjendje civile 4” në Drejtorinë e administratës së përgjithshme.

Nga ato që u thanë më lartë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.908/2022, datë 09.12.2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Ardita Perçuku-Shyti
Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Ferizajit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.